



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština - Municipality of Prishtina

<b>Datë/a:</b>	04.06.2021
<b>Referenc-ë:</b>	07-353/94906/21
<b>Për/ Za/ To:</b>	Instituti i Pavarur i Ushqimit
<b>Përmes/Preko/Through:</b>	Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit
<b>Nga/ Od/ From:</b>	Punoi: Liridona Kastrati, zyrtare për hapësira publike Kontrollori: Habib Qorri, udhëheqës i sektorit
<b>Tema/ Subjekat/Subject:</b>	<b>Pëlqim</b>

Drejtorija për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim ka pranuar kërkesën me nr protokoll 07-353/94906/21 nga Instituti i Pavarur i Ushqimit me të cilën kërkohet shfrytëzimin e hapësirës publike, Sheshi "Zahir Pajaziti" si dhe vendosja e një tende me datë 7 Qershor 2021. Qëllimi i kërkesës është shënim i Ditës Botërore të sigurisë në ushqim.

Drejtorija pas shqyrtimit të kërkesës, duke u bazuar në nenin 4, pika 2, shkronjës i) të Rregullores për "Vendosjen, Ndërtimin dhe Largimin e Objekteve të Përkohshme në Pronë Publike" me nr.01-110-157481, jep pëlqimin për shfrytëzimin e hapësirës publike në Sheshin "Zahir Pajaziti" me datë 7 Qershor 2021 sipas kërkesës së parashtruar. Shpërndarja e fletushkave nuk lejohet sepse po hudhen në hapësira publike.

Kushtet e pëlqimit:

- Të respektohen të gjitha masat dhe rregullat e përcaktuara nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës për organizimin dhe mbajtjen e aktiviteteve publike;
- Varësisht nga vendimet e IKSHP-së dhe Ministrisë për parandalimin e përhapjes së pandemisë, kushtet e pëlqimit mund të ndryshohen apo të bëhet pezullimi.

Vërejtje: pala është e obliguar që të respektojë të gjitha pikat e cekura më lartë, në të kundërtën pëlqimi konsiderohet i pezulluar.